

## **Efiçienca e buxhetit të Bashkisë Divjakë (Viti 2020)**

### **1. Analiza e parashikimit të tē ardhurave për vitin fiskal 2020**

Studimi ka për qëllim të analizojë efiçencën dhe shpenzimet e tē ardhurave për vitin 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

**Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve**

<b>Burimet e financimit</b>	<b>(Vlera në 000 Lekë)</b>	<b>(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë</b>	<b>% mbi totalin e tē ardhurave</b>
<b>Transferta e pakushtëzuar</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	212,257	2,060,748	24 %
<b>Transferta e pakushtëzuar</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	330,000	3,203,883	38 %
<b>Transferta e pakushtëzuar sektoriale</b> (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	104,087	1,010,553	12 %
<b>Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore</b> (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	230,453	2,237,408	26.3 %
<b>TOTALI</b>	<b>876,797</b>	<b>8,512,592</b>	<b>100 %</b>

Burimi: Bashkia Divjakë (llogaritje EIC)

**Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Divjakë 2020**



Burimi: Bashkia Divjakë (llogaritje EIC)

## 2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Divjakë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fonave, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përsë shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përbledhëse të shpenzimeve:

**Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale**

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
<b>Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore</b>	164,400	1,596,117	18.8
<b>Shpenzime Korrente</b>	128,561	1,248,165	14.7
<b>Shpenzime Kapitale</b>	159,500	1,548,544	18.2
<b>TOTALI</b>	<b>452,461</b>	<b>4,392,825</b>	<b>51.6 %</b>


Burimi: Bashkia Divjakë (llogaritje EIC)

**Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale**



Burimi: Bashkia Divjakë (llogaritje EIC)

**Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si rapport mbi të ardhurat lokale**



Burimi: Bashkia Divjakë (llogaritje EIC)